



Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Vendimi nr.12/19
Data: 11 Mars 19

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbështetje të nenit 28.29.34, 35.2, neni 50, neni 54 paragrafi 1.3 si dhe nenit 13, 15, 17, 18, 19, 20 të Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës, (dhe Plotësim Ndryshimit të Ligjit nr. 04/1.-226, Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi 1.3 Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrive. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant. në mbledhjen e datës 11 Mars 2019, mori këtë:

VENDIM

- I. LE.JOHET, Përqendrimi përmes përfitimit 100% të kontrollit nga Ipko Telecommunications L.L.C, në cilësinë e blerësit, me numër të regjistrimit të biznesit 70064420 dhe me adresë në Rruga Zija Shemsiu Nr. 34.10000 Prishtinë. mbi Vision TV SH.P.K me nr. të regjistrimit të biznesit 70965380 (dhe me adresë, në Rruga Zahir Pajaziti 11000 Podujevë. në cilësinë e shitësit.
 - II. Parashtruesi i Njoftimit për Përqendrim obligohet të paguhet taksë administrative prej 100.00 €. me shkronja (Njëqind euro dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me Nenin 20 të Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3.000.00 € me shkronja (tre mijë euro).
111. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

ARSYETIM

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me datë 22.01.2019 ka pranuar kërkesën për Njoftimin e Përqendrimit, nga IPKO Telecommunication, me numër të regjistrimit të biznesit 70064420 dhe me adresë të regjistruar në Rruga "Zija Shemsiu" Nr.34.10000, Prishtinë mbi Vision TV Sh.P.K me numër të regjistrimit të biznesit 70965380 dhe me adresë biznesit 70965380 dhe me adresë të regjistruar në Rruga Zahir Pajaziti 11000 Podujevë.

Njoftimi për Përqendrim ka të bëjë, me:

Blerjen e asetëve dhe transferimin e përdoruesve të fundit me marrëveshjet e nënshkruara më datë 14.01.2019 (Kontratë e Shitblerjes) ndërmjet IPKO Telecommunication L.L.C në cilësinë e blerësit dhe Vision TV SH.P.K, në cilësinë e shitësit.

Nëpërmjet Kontratës së Shitblerjes do të realizohen transferimi i i asetëve të Vision TV si (palë shitëse), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjisllacionit të Republikës së Kosovës, me numër të regjistrimit të biznesit 70965380. numër fiskal 600982046 dhe me adresë të regjistruar në Rruga. 7.Zahir Pajaziti,11000 Podujeve. tek (pala blerëse) IPKO Telecommunications L.L.C. Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjisllacionit të Republikës .së Kosovës. me numër të regjistrimit të biznesit 70064420. numër fiskal 600178893 dhe me adresë të regjistruar në Rrugën Zija Shemsiu Nr.34, 10000 Prishtinë.

Baza ligjore dhe akti i Përqendrimit

Sipas nenit 15, të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Të hyrat e përgjithshme të së paku dy (2) pjesëmarrës në përqendrim në tregun e brendshëm të Kosovës, janë më shumë se tre (3) milionë Euro sipas raporteve financiar e që i paraprinë vitit të përqendrimit.
2. Të dy palët në Përqendrim janë të regjistruara në Republikën e Kosovës.
3. Kontratat e Shitblerjes ndërmjet palëve, për asete dhe tranferimin e përdoruesit fundor, datë 14.01.2019.

Pjesëmarrësit në Përqendrim (palët në transaksion):

Blerësi

IPKO Telecommunications L.L.C., është opertor i licencuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, licenca me numër rendor 206/A/14 te datës 7 korrik 2014. si dhe nga Komisioni i Pavarur i Mediave, licencat me numër rendor 1 807/836/LIC/ni,të datës I gusht 2018.IPKO ushtron veprimtari, në fushën e ofrimit të shërbimeve të internetit dhe televizionit kabllor në tërë territorin e Republikës së Kosovës ,tash e tutje referuar si "Licencat e IPKO-së dhe bashkangjiitur këtu si Shtojca D.Për vitin fiskal deri më 31 dhjetor 2017 në tregun e Kosovës ka një xhiro/lë hyra prej:

██████████. IPKO nuk ka shitje në tregun ndërkombëtar.

Shitësi

Operatori Ekonomik Vision TV është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e licencuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, licenca me numër rendor 093/A/16 të datës 16 Maj 2016 -si dhe nga Komisioni i Pavarur i Mediave, licencë me numër rendor OK32, të datës 30 Tetor 2013. keto të dhëna janë të paraqitura në certifikatën e biznesit dhe informatat e biznesit të Vision TV. bashkangjitur këtu Shtojca G. Në bazë të raportit financiar Vision TV të datës 1 janar deri me 31 dhjetor 2017 ka paraqitur ██████████

Forma juridike e përqendrimit dhe qëllimi ekonomik nga për shkrimi i kërkesës

Bazuar në kontratën e shitblerjes, shitësi do të shes dhe transferojnë tek blerësi të gjitha asetet dhe transferimin e përdoruesit fundor të Vision TV ndërsa në përfundim të transaksionit IPKO Telecommunications do të blejë dhe zotërojë 100% të aseteve të Vision TV. Me këtë transaksion, blerësi synon të rrisë nivelin e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve në tregun e Republikës së Kosovës duke blerë një shoqëri ekzistuese. Përfitimi i kontrollit në Vision TV, do t' i mundësojë blerësve të përfitojnë strukturën ekzistuese organizative të shoqërisë e cila së bashku me përvojën do të mundësojë një rritje të eficiencës në ofrimin e produkteve, Në përfundim të transaksionit së propozuar Blerësit do të bëhen zotëruar të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga zotërimi i aseteve të Vision TV-së sipas legjisllacionit të Republikës së Kosovës. Shitësi Vision TV sipas Marrëveshjes së Shitblerjes do t' i bartë IPKOS-së, të gjitha autorizimet, licencat ose edhe lejet në lidhje me pasuritë që janë lëshuar/autorizuar nga Komisioni i Pavarur i Medias (KPM), Komuna e Podujevës dhe Komuna e Vushtrisë dhe do të dorëzojë IPKO-së të gjitha planet, ose projektet e vecanta mbi infrastrukturën dhe paisjet shoqëruese, si dhe të gjithë dokumentacionin përkatës të Aseteve (përfshirë garancitë e prodhuesit dhe të ngjashme).

Tregu Relevant

Tregu gjeografik në transaksionin e propozuar, është territori i Republikës së Kosovës.

Tregu i produktit është, ofrimi i Shërbimit të Internetit dhe Televizionil Kabllor.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar është transaksion që do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Kosovës, dhe palët në Përqendrim janë ndërmarrje që janë të regjistruara dhe veprojnë vetëm në tregun e Republikës së Kosovës. Nga transaksioni nuk do të

rezultojnë efekte negative për konkurrencën e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës, sepse qarkullimi i targetit është modest, gjithashtu veprimtaria e tij shtrihet vetëm në dy komuna (Podujevë dhe Vushtrri) të Republikës së Kosovës.

Vëmendie

Cdo formë e shtrembërimit të konkurrencës respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim merr epilogun, si në dispozitiv të këtij VENDIMI,

Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva
- Të publikohet në Web/faqe të AKK-së

KOMISIONI AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS


Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar


Fatime Plaziri
Anëtare


Muhamed Krasniqi
Anëtar


Shaqir Morina
Anëtar

